



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

PRILL 2026

Nr.	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigjia	Statusi	Pagesa
1.	27.03.2026	Sa asgjësime ka kryer subjekti "L*** C*** N***" nga Janari 2026 deri në 30 Mars 2026 ?	31.03.2026	Nga verifikimet e kryera në sistemin e-inspektimi për periudhën e kërkuar Janar 2026 deri në 30 Mars 2026 subjekti ka kryer një procedurë asgjësimi.	Përfunduar	Nuk ka
2.	30.03.2026	1.Cili është standarti ligjor i rrjedhës ekologjike që aplikohet në Shqipëri për zonat e mbrojtura? 2.A ka ministria juaj një strategji ose udhëzim	01.04.2026	Në vijim të informacionit të kërkuar administruar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit me Nr.5134 Prot, datë 30.03.2026 me lëndë " <i>Kërkesë për informacion</i> " për projekte që prekin në Parkun Kombëtare Shebenik–Jabllanicë: Pika 1 dhe 2 nuk janë kompetencë e sektorit të VNM-së. Në lidhje me pikën 3, ju informojmë se: Në zbatim të Ligjit Nr.10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis,te ndryshuar dhe VKM Nr.686,	Përfunduar	Nuk ka

		<p>specifik për mbrojtjen e rrjedhës ekologjike në parqet kombëtare? 3.Sa leje mjedisore ose VNM janë miratuar nga viti 2015 për projekte që prekin në Parkun Kombëtar Shebenik-Jabllanicë dhe zonën përreth: lumenjtë, përrenjtë, burimet ujore? 4.A është kryer ndonjë audit mjedisor apo rishikim i lejeve ekzistuese për shkak të ndikimit në rrjedhën ekologjike?</p>		<p>datë 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjësi e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, në sistemin e-leje ka aplikuar subjekti "A*** ALBANIA", për projektin “M*** C***, Fushë Studen” me vendndodhje: Librazhd, Parku Kombëtar “Shebenik-Jabllanicë”, Elbasan.</p> <p>Aplikimi është bërë, Shtojca II: Pika 12. Turizmi dhe koha e lirë. ç) Vendet për kampe të përhershme dhe karavane; C) Fshatra turistike dhe komplekse hotelesh jashtë zonave urbane bashkë me zhvillimet që i shoqërojnë ato;</p> <p>Ky vendim nuk është leje zhvillimi përfundimtare për zbatimin e këtij projekti, por është një dokument i cili lëshohet me kusht që në rast se do të zhvillohet ky aktivitet, duhet të zbatohet kushtet e vendosura si detyrim që vjen nga Ligji Nr.10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe Ligji Nr.10440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar,(bashkëlidhur vendimi i VNM me kushtet përkatëse).</p> <p>Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.</p> <p>Në lidhje me pikën 3 "Sa leje mjedisore ose VNM janë miratuar që nga viti 2015 për projekte që prekin në Parkun Kombëtar Shebenik-Jabllanicë dhe zonën përreth: Lumenjtë, Përrenjtë, Burimet ujore, ju informojmë se veprimtaritë të cilat pajisen me leje mjedisi janë të përcaktuara në shtojcën e ligjit 10448/2011 "Për Lejet e Mjedisit", i ndryshuar.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p>Në faqen zyrtare të AKM-së janë të publikuara lista e subjekteve të cilat disponojnë Leje Mjedisi</p> <p>https://akm.gov.al/ova_doc/baza-e-te-dhenave-per-lejet-e-mjedisit-tipi-a-b-per-periodhen-janar-2014-korrik-2024/.</p>		
3.	30.03.2026	<p>Për basenet ujore: Vjosë, Devoll, Shkumbin, Seman, Mat</p> <p>kërkoj të më vihet në dispozicion informacioni dhe dokumentacioni:</p> <p>-Sa % e subjekteve të clat përdorin këto basene ujore kryejnë vet raportim të rregullt sipas kushteve të VNM-së të miratuar nga AKM për 5 vitet e fundit?</p> <p>-Ç'farë masash merren për subjektet që nuk vet-raportojnë</p>	08.04.2026	<p>Në përgjigje të shkresës suaj me lëndë: “<i>Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare</i>” Ju informojmë si vijon:</p> <p><i>Së pari:</i> Në datën 17.02.2026 nëpërmjet adresës elektronike koordinator@akm.gov.al kërkuesi ka kërkuar informacion në lidhje me ndotjen bakteriale të liqenit të Tiranës, e cila është administruar në AKM me Nr.3428 Prot. Përgjigjia e kërkesës në fjalë është trajtuar dhe komunikuar në datën 20.02.2026.</p> <p>Mbi pretendimin e z.H*** se institucioni publik (AKM) ka refuzuar dhënien e informacionit bëjmë me dije se kërkesa në fjalë nuk është paraqitur në AKM (me e-mail ose nëpërmjet zyrës së protokollit).</p> <p><i>Së dyti:</i> mbi kërkesën për informacion dhe pyetjet e parashtruara nga nga kërkuesi:</p> <p>Agjencia Kombëtare e Mjedisit, përmes strukturave të saj të inspektim-kontrollit për burimet natyrore (ujëra), kryen inspektime në terren në kuadër të inspektimeve të planifikuara periodike, si dhe mbi bazë indiciesh dhe ankesash të ardhura nga palë të treta.</p> <p>Sqarojmë se AKM ushtron kompetencat e saj përmes procedurave të inspektimit të formalizuara, në kuptim të legjislacionit në fuqi, ndërsa verifikimet paraprahe ose faktmbledhëse, kur nuk shndërrohen në inspektim, nuk përbëjnë procedurë inspektimi dhe nuk gjenerojnë të dhëna zyrtare të regjistruara apo statistikore.</p> <p>Nga inspektimet e kryera në terren në aktivitetet pranë lumenjve, në basenet lumore që përmendni, nga ana e</p>	Përfunduar	Nuk ka

		<p>sipas detyrimit ligjor? -Sa është numri i masave të marra ndaj këtyre subjekteve për periudhën 2018-2025? -Sa raporte vetëmonitorimi verifikohen në terren nga AKM krahasuar me nurmin e raporteve të vetëmonitorimit të dorëzuar? -Sa herë ka dalë AKM në terren për verifikim në periudhën 2018-2025? -A ka gjetur AKM shkelje të kuadrit ligjor dhe a ka pezulluar leje shfrytëzimi për periudhën 2018-2025? -Nëse po, sa leje janë pezulluar dhe cilat kanë qenë hapat pasardhës?</p>		<p>AKM-së dhe strukturave të varësisë, janë konstatuar raste shkeljesh të kuadrit ligjor në fuqi, për të cilët janë marrë masa administrative, ku përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Subjekti “G****” sh.p.k., lumi Shkumbin – shfrytëzim inertesh pa leje përkatëse nga organet e menaxhimit të burimeve ujore; masë administrative gjobë 1.000.000 lekë dhe pezullim i veprimtarisë; Nga verifikimi i bazës së të dhënave në sektorin e VNM-së nuk rezulton të ketë njoftuar për fillimin e punimeve. • Subjekti “A****” sh.p.k., lumi Shkumbin – shfrytëzim dhe depozitim inertesh pa leje; masë administrative gjobë 1.000.000 lekë; Nga verifikimi i bazës së të dhënave në sektorin e VNM-së rezulton njoftimi për fillim punimesh datë 06.02.2025. • Subjekti “V*** H****”, lumi Devoll – përdorim i burimit ujor dhe nxjerrje inertesh pa leje/autorizim nga organet kompetente; masë administrative gjobë 2.000.000 lekë dhe detyrim për pajisje me lejet përkatëse; Nga verifikimi i bazës së të dhënave në sektorin e VNM-së nuk rezulton të ketë njoftuar për fillimin e punimeve. • Subjekti “I*****”, lumi Shkumbin – konstatuar indicie për nxjerrje inertesh në shtratin e lumit; ndaj subjektit është marrë masë administrative paralajmërim dhe detyrim për ndërprerje të menjëhershme të veprimtarisë pa leje; Nga verifikimi i bazës së të dhënave në sektorin e VNM-së subjekti nuk rezulton në bazën e të dhënave . • Gjithashtu janë marrë masa administrative ndaj subjekteve të tjera që kanë ushtruar aktivitet në brigje ose shtretër lumenjsh, si ndaj: “I** spa”, “HEC G*** 2” nga verifikimi i bazës së të 		
--	--	---	--	---	--	--

				dhënave raportimi i fundit është Shtator 2025 - Mars 2026 ; “A**** I****” nga verifikimi i bazës së të dhënave nuk rezulton të ketë njoftuar për fillimin e punimeve.; “B*** E****”, “V*** Energji” Nga verifikimi i bazës së të dhënave rezulton njoftuar për pezullimin e punimeve datë 07.08.2024.“V*** sh.p.k.”, sipas rasteve konkrete dhe shkeljeve të konstatuara.		
4.	02.04.2026	-Cilat janë, në praktikë, vështirësitë kryesore që hasen në procedurat e VNM-së dhe të lejeve mjedisore për zhvillime industriale me shumë operatorë në të njëjtën zonë? -Si e vlerëson AKM trajtimin e marrëdhëni-es ndërmjet VNM-së së parkut në tërësi dhe detyrimeve eventuale të operatorëve individualë që vendosen më pas në park? -A e mundëson kuadri aktual, sipas vlerësimit	07.04.2026	Në mbështetje të Ligjit Nr.12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin Nr.10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, dhe VKM Nr.714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr.686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, aplikime të aplikuara në e_Albania sipas shtojcave I dhe II të Ligjit. Në zbatim të gjitha detyrimet ligjore që vijnë nga: <ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr.10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”. • Ligji Nr.12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” • VKM Nr.686, date 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” te ndryshuar, Bazuar në ligjin Nr.10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, dhe VKM-në Nr.686, date 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së	Përfunduar	Nuk ka

		të AKM-së, trajtimin efektiv të ndikimeve kumulative mjedisore dhe të infrastrukturës së përbashkët, në nivel parku? -Ç'farë qartësimesh ose përmirësimesh procedurale do të vlerësonte AKM si të nevojshme për të lehtësuar zbatimin praktik të modelit të EIP-ve, pa cënuar standardet e mbrojtjes së mjedisit?		<p>transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” të ndryshuar, projekti duhet të ketë marrë para fillimit të procedurës së VNM-së miratimet përkatëse për vendndodhjen e projektit të propozuar, në mbështetje të kriterëve ligjore të menaxhimit të mbetjeve, territorit duke vlerësuar me prioritet ndikimin në mjedis dhe komunitet.</p> <p>Të gjitha veprimtaritë të cilat pajisen me leje mjedisore janë të përcaktuara në shtojcën 1 të ligjit Nr.10448 datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit" i ndryshuar. Nëse veprimtaritë të cilat do të operojnë në këtë sipërfaqe, operatorë të ndryshëm duhet të pajisen me leje mjedisore të ndryshme bazuar ligjit Nr.10448/2011 "Për Lejet e Mjedisit" i ndryshuar.</p> <p>Të gjitha instalimet që mund të pajisen me leje mjedisi duhet të zbatojnë kuadrin ligjor sectorial, ligjet mjedisore, ligjit Nr.10431/2011 "Për mbrojtjen e Mjedisit" i ndryshuar, Ligjin Nr. 10448/2011 "Për Lejet e Mjedisit" i ndryshuar, Ligjin Nr. 57/2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" etj., si dhe aktet nënligjore.</p>		
5.	03.04.2026	Lutemi të na vendosni një kopje të procedurës së asgjësimit të subjektit L*** C** N***?	10.04.2026	<p>Në zbatim të legjislacionit mjedisor në fuqi, ligjit Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, ligjit Nr. 57/2025, datë 16.10.2025, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, ligjit Nr. 10 448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, VKM Nr.568, datë 17.07.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, ju bëjmë me dije se:</p> <p>Nga verifikimet e kryera në sistemin ”e-inspektimi” për periudhën e kërkuar Janar 2026 deri në 30 Mars 2026, subjekti “L*** C*** N***” ka kryer 1</p>	Përfunduar	Nuk ka

				<p>procedurë asgjësimi në datën 13.03.2026. Produkti i asgjësuar ka qenë “Qumësht pluhur Aptamil” i bllokuar nga D*** Tiranë, me peshë bruto bashkë me paketim 14840 kg.</p> <p>Bashkëlidhur gjeni: - Procesverbalin e Inspektimit - Formular i transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme</p>		
6.	09.04.2026	<p>Mbështetur në një shqetësim institucional të konstatuar në disa zyra të institucionit të Agjencisë së Trajtimit të Pronave dhe referuar misionin që ka AKM “..për mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit si një pasuri jetike për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, ... dhe bazuar në funksionin e Agjencisë Kombëtare të</p>	16.04.2026	<p>Në vijim të kërkesës suaj me Nr. 5699 prot, datë 09.04.2026, lidhur me shqetësimin e paraqitur për cilësinë e ajrit në ambientet e brendshme të punës të Agjencisë së Trajtimit të Pronave, ju informojmë se, pas shqyrtimit institucional të saj, rezulton se verifikimi dhe monitorimi i kushteve mjedisore në ambiente të brendshme pune nuk përfshihet në kompetencat funksionale të Drejtorisë së Menaxhimit të të Dhënave, Kimikateve, Analizave Laboratorike dhe Inovacionit pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.</p> <p>Për rrjedhojë, vlerësojmë se trajtimi i këtij shqetësimi, përfshirë kryerjen e inspektimeve fizike në vend dhe dhënien e udhëzimeve përkatëse, është në fushën e përgjegjësisë së strukturave kompetente për shëndetin dhe sigurinë në punë, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Duke ju falënderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin, ju sigurojmë për gatishmërinë tonë për çdo sqarim të mëtejshëm brenda fushës sonë të përgjegjësisë institucionale.</p>	Përfunduar	Nuk ka

	<p><i>Mjedisit; a)</i> <i>Sigurimi i</i> <i>performancës</i> <i>mjedisore;"" ,</i></p> <p>ju paraqesim kërkesën si vijon:</p> <p>Gjatë kësaj jave nga punonjësit e disa zyrave të institucionit, në katin e parë dhe të dytë është ngritur shqetësimi se kur vijnë në mëngjes në zyrë konstatojnë ajër jo të pastër me aroma të pakëndshme të papërcaktuara kimikatesh. Nga strukturat përkatëse që merren me mirëmbajtjen e ambienteve janë kryer shërbimet e nevojshme për higjenizim dhe është ngritur grup pune për të përcaktuar arsyen e këtij shqetësimi të</p>				
--	--	--	--	--	--

		<p>ngritur nga disa zyra, por nuk është konstatuar asnjë arsye për këtë situatë e cila vijon të jetë shqetësuese.</p> <p>Sa më sipër, kërkojmë bashkëpunimin tuaj, për verifikimin e situatës dhe udhëzimet e nevojshme ligjore për normalizimin dhe mbarëvajtjen e punës.</p>				
7.	09.04.2026	<p>Cilat janë vendimet dhe dokumentet e miratuara nga AKM në kuadër të vlerësimit të ndikimit në mjedis për segmentet e Korridorit VIII që kalojnë pranë ose përgjatë lumit Shkumbin?</p>	15.04.2026	<p>Në përgjigje të kërkeses tuaj, rregjistruar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit me Nr.5702 Prot., datë 09.04.2026, me objekt "Kërkesë për informacion mbi projektin e koridorit VIII" , ju bëjmë me dije se: Në zbatim të Ligjit Nr.10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", të ndryshuar , VKM 686, datë 29.07.2015, "Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", të ndryshuar - AKM-ja shqyrton aplikime të ardhura në sistemin e_Leje, në e_Albania, projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara</p>	Përfunduar	Nuk ka

		<p>A është kryer një vlerësim i ndikimit në mjedis (VNM/EIA) për këto segmente dhe cilat janë përfundimet kryesore të tij në lidhje me lumin Shkumbin? A përfshin VNM ndëryrje në shtratin, brigjet apo rrjedhën e lumit Shkumbin dhe si janë vlerësuar këto ndërhyrje? A janë identifikuar në VNM rreziqe të mundshme si erozioni, ndryshimi i rrjedhës apo ndikimi në ekosistemin e lumit? Cfarë masash zbutëse dhe mbrojtëse janë parashikuar për të minimizuar ndikimin në lumin Shkumbin gjatë dhe pas</p>		<p>dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit. , Njoftojmë se në faqen e web-it janë të publikuara të gjitha vendimet e dhëna nga AKM-ja, dhe janë publike. • <i>Kërkesa për sigurimin e informacionit mbi zbatimin e projektit, karakteristikat e tij dhe elementët kryesore të tij në zonat ku zhvillohet projekti?</i> - Institucioni kompetent për këtë informacion është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH).</p>		
--	--	--	--	---	--	--

		<p>ndërtimit të rrugës? A është parashikuar përdorimi i materialeve inerte nga shtrati i lumit dhe si është vlerësuar ndikimi i këtij aktiviteti në mjedis? A janë vendosur kushte specifike mjedisore për ndërhyrjet në lumin Shkumbin dhe cilat janë ato? A monitoron AKM zbatimin e kushteve mjedisore gjatë punimeve dhe cilat janë rezultatet e këto monitorimi deri më tani? A janë konstatuar shkelje të kushteve mjedisore gjatë zbatimit të projektit dhe çfarë masash</p>				
--	--	---	--	--	--	--

		<p>janë marrë në këto raste? A disponon AKM raporte periodike mbi ndikimin e projektit në lumin Shkumbin dhe a mund të vihen ato në dispozicion? A është përditësuar VNM gjatë zbatimit të projektit në rast të ndryshime-ve në terren dhe cilat janë këto ndryshime? Cilat institucione të tjera kanë qënë të përfshira në procesin e miratimit dhe monitorimit mjedisor të këtij projekti?</p>				
8.	16.04.2026	1.A disponon AKM të dhëna statistikore mbi gjenerimin, grumbullimin, trajtimin dhe/ose	21.04.2026	1.Në zbatim të Vendimit Nr. 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme” të ndryshuar dhe VKM-së Nr. 371, datë 11.06.2014, “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre” të ndryshuar, AKM disponon të	Përfunduar	Nuk ka

		<p>riciklimin e mbetjeve elektrike dhe elektronike (MEE)?</p> <p>2.Sa kompani private janë të licencuara për menaxhimin e mbetjeve elektronike dhe cilat janë të dhënat statistikore lidhur me aktivitetet e kryera nga secila prej tyre?</p> <p>3.Në çfarë faze implementimi është krijimi i Regjistrit Elektronik sipas Nenit 70 "Kërkesa për mbajtjen e të dhënave" të ligjit Nr. 57/2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" dhe cila pjesë e tij është e</p>	<p>dhëna të cilat publikohen në Raportin e Gjendjes së Mjedisit që përgatit çdo vit dhe publikohet në faqen e web-it https://akm.gov.al/raporte-dhe-publikime/</p> <p>2.Operatorët e pajisur me Leje/ Licenca janë të publikuar në regjistrin kombëtar të Autorizimeve, Lejeve dhe Licencave pranë QKB-së në linkun e mëposhtëm: https://qkb.gov.al/leje-licensa-autorizime/ Në faqen zyrtare të AKM-së është e publikuar lista e subjekteve të pajisura me leje mjedisi Tipi A dhe B dhe licenca III.2.B për periudhën Janar 2014 - Mars 2026. https://akm.gov.al/ova_doc/baza-e-te-dhenave-per-lejet-e-mjedisit-tipi-a-b-per-periudhen-janar-2014-korrik-2024/ https://akm.gov.al/ova_doc/baza-e-te-dhenave-per-licencat-iii-2-b-per-periudhen-2012-maj-2024/.</p> <p>3.Bazuar në Vendimin Nr. 672, datë 12.11.2025 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të integruar mjedisor", AKM ka ngritur Sistemin e Integruar Mjedisor (SIM), i cili ka dalë live në 12 Shkurt të vitit 2026. Ky sistem ka edhe faqen e dukshme për publikun ku do të dalin të dhënat e përpunuara.</p> <p>4. Pyetja në fjalë i përket Ministrisë së Mjedisit. 5. Pyetja në fjalë i përket Ministrisë së Mjedisit. 6. Pyetja në fjalë i përket Ministrisë së Mjedisit. 7. Pyetja në fjalë i përket Ministrisë së Mjedisit. 8. Pyetja në fjalë i përket Ministrisë së Mjedisit. Subjektet e pajisur me licencë eksporti raportojnë në ministri çdo 6 muaj. 9. Baza ligjore egziston për secilin proces.</p>		
--	--	--	---	--	--

	<p>aksesueshme për publikun?</p> <p>4.Në çfarë mase është implementuar ligji Nr.74/2025 "Për përgjegjësitë e zgjeruara të subjekteve prodhuese të produkteve që gjenerojnë mbetje" për sa i përket mbetjeve elektronike?</p> <p>5.Cila është praktika e ndjekur për bashkëpunimin me operatorët privatë apo publikë në funksion të implementimit të këtij ligji?</p> <p>6.Cilat sfida janë identifikuar në zbatimin e përgjegjësi-së së zgjeruar të prodhuesit (EPR) dhe në sigurimin që prodhuesit të</p>				
--	--	--	--	--	--

	<p>përmbushin detyrimet e tyre?</p> <p>7.Në çfarë mase është arritur objektivi M11 i Dokumentit të politikave strategjike dhe Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve lidhur me skemat EPR për rrjedhat specifike të mbetjeve (gomat, bateritë, WEEE, etj.)?</p> <p>8.Çfarë sistemesh përdoren aktualisht për të monitoruar gjenerimin, mbledhjen dhe lëvizjen ndërkufitare të mbetjeve elektronike?</p> <p>9.Cilat boshllëqe infrastrukturore (pikat e mbledhjes,</p>				
--	---	--	--	--	--

		facilitetet e sortimit, impiantet e riciklimit) konsiderohen më urgjente në fushën e mbetjeve elektronike?				
--	--	--	--	--	--	--